

**RAPORT I VLERESIMIT
TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER PROJEKTIN**

**“PËR RITJEN E SIGURISË SË DIGËS DHE PËRMIRËSIMIN E UJTJES
ME REZERVUARIN E KURJANIT”
BASHKIA ROSKOVEC**

TIRANE Korrik 2023



PERMBAJTJA

I. - PARATHENIE

II. - HYRJE

a.- Pershkrim i pergjithshem

b.- Kuadri ligjor

c.- Karakteristikat fizike

III. - PERSHKRIMI I PROJEKTIT


a.- Pershkrimi i hollesishem i te gjithe objektit

IV.- TE DHENA PER MJEDISIN EGZISTUES

**V.- NDIKIMI I MUNDESEM NE MJEDIS DHE MASAT E PROPOZUARA PER
PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E TYRE**

VI.- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

VII.- PERFUNDIME



I.- PARATHËNIE

Shqipëria, si palë nënshkruese e një numri konventash ndërkombëtare, kontratave dhe dokumentave të tjera ligjore është e detyruar të zbatojë një sistem efektiv për administrimin e tokës, ujit dhe ajrit, jo vetëm në drejtim të zgjidhjes së problemit, por edhe të zbatimit të përgjegjësive të saj nën këto marrëveshje ndërkombëtare.

Mbrojtja e mjedisit, si një sistem dinamik, që ndryshon herë pas here fizikisht dhe biologjikisht, duhet parë në tërësinë e faktorëve natyrorë dhe të veprimit njerëzor që ushtrohet mbi të.

Zhvillimi urban në Bashkinë Roskovec jep një ndikim të caktuar, duke goditur pak a shumë natyrën përreth, sidomos kur parametrat e ndërtimit dhe të menaxhimit të tij nuk analizohen konform ligjeve e rregullave të natyrës, në dobi të ruatjes së ekuilibrave e të ekosistemeve të saj.

Një ndër burimet e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit janë zhvillimet urbane, që sipas natyrës dhe mënyrës teknike të aplikuar shkaktojnë ndotje, me sasi dhe natyra të ndryshme, midis të cilave më të rëndësishme janë:

- □Gjatë operacioneve të ndërtimit, dhe pastaj edhe të funksionimit;
- □Sistemi teknologjik i furnizimit me lëndë të parë dhe eliminimi i mbetjeve të tyre;
- □Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit;
- □Sistemi mbrojtës nga përmytjet dhe rreziqet e mundshme natyrore;

Metodat e uljes së ndotjes, në zhvillime urbane si qendra banimi, biznesi, shlodhëse, etj, konsistojnë në perfeksionimin e teknikave të mirëmbatjes dhe mirë menaxhimit të zonave të komplekseve të ndërtimit, por mbi të gjitha në marrjen e masave kundrejt atyre faktorëve që mund të ndikojnë negativisht ndaj parametrave natyrorësh të shëndetësor.

Këto ndërtime japin një efekt të caktuar, duke goditur pak a shumë natyrën përreth, sidomos kur parametrat e ndikimit të saj nuk analizohen konform ligjeve e rregullave të natyrës, në dobi të ruatjes së ekuilibrave e të ekosistemeve të saj.

Nxitja e tyre kërkon një përkujdesje më të madhe nga ana e organeve legislative dhe vendimmarrëse, në mënyrë që të rritet interesi për ndërtime dhe aktivitete të tilla, si dhe shoqëria investuese duhet të tregojë interes, si për zhvillimet në fushën e ndërtimit, dhe në ruatjen e ekuilibrave natyror, dhe veçanërisht në ruatjen e ekosistemeve.



II.- H Y R J E

a.- Pershkrimi i pergjithshem

Objekti ““për rritjen e sigurisë së digës dhe përmirësimin e ujitjes me rezervuarin e kurjanit” Bashkia Roskovec.” ndodhet ne Njesine Administrative Suk Strum te Bashkise Roskovec.

Objekti ka disa nenobjekte:


- 1-Rindertimi Stacionit pompimit te Matkes, pozicionuar ne vendin ku ka qene dhe eshte gjurma e stacionit te vjeter.
- 2- Vaska e thithjes dhe tubacionet e dergimit me gjatesi te ndryshme qe marrin uje te ky stacion dhe e percjell per ne kanlin ujites VMK-1 si dhe ne ate transportues për ne rezervuarin e Kurjanit .
- 3-Kanali transportues nga dalja e tubacionit te dergimit deri ne derdhjen ne rezervuarin e Kurjanit.
4. Stacioni i Pompimit te ri në zonen e Suk, Hoxhenj.
5. Vaska e thithjes dhe tubacionet e dergimit nga stacioni ri i pomp ne Suk Hoxhenj deri ne kanalin ujites (ekzistues) V3, pas argjinatures se lumit.
- 6-Rrjeti kanaleve ekzistues, ujites dhe kullues, si kanale transportues per te percjell ujin (nga lumi Semanit) pas ngritjes me stacionin e pompimit Suk-Hoxhenj Nr 2, deri ne Vasken e thithjes se stacionit pompimit Matke.

B- KUADRI LIGJOR

Ky raport i Vleresimit dhe Ndikimit ne Mjedis eshte hartuar duke patur parasysh:

Legjislacionin e Shtetit Shqiptar dhe te Komunitetit European, me akte juridike ligjore dhe nenligjore specifike qe rregullojne ushtrimin e aktivitetit te investimeve dhe gjithashtu aktet ligjore lidhur me mbrojtjen e mjedisit si me poshte:

1. Ligji per Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 8934, dt. 23.01.2003, 05.09.02 neni 26 “Procesi I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.
2. Ligji Nr. 8990, date 23.01.2003, neni 8 dhe 9 “Mbi vleresimin e ndikimit ne mjedis”
3. Ligji “Leja per veprimtarite qe ndikojne ne mjedis”
4. Ligji “Per token” nr. 7501 dt.27.01.1995



5. Udhezues Nr. 6 i Ministrise se Mjedisit, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie"

6. VKM per "Sigurimin dhe Informacionin e Mjedisit e Drejta e Publikut per Informacion", dt.06.01.1998

7. Ligji nr. 8990, dt.23.01.2003 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis"

C.- Karakteristikat klimaterike e hidrologjike te zones

KLIMA

Sipas ndarjes klimatike të dhënë në Klimën e Shqipërisë (Botim I Institutit Hidmet Tirana,)zona e Roskovecit bën pjesë në Zonën Klimatike Mesdhetare Fushore, e cila karakterizohet nga dimra të butë e të lagësht dhe vera të nxehta e të thata.

Regjimi i rrezatimit diellor

Në përgjithësi, kjo zonë karakterizohet nga vlera relativisht të larta të diellzimit dhe rrezatimit diellor. Konkretisht, në këtë zonë vrojtohen deri në rreth 2 536 orë në vit me diell dhe sasia mesatare vjetore e energjisë diellore është 4036.0 wh/m²ditë.

Rrezatimi diellor direkt, ai i shpërndarë dhe shumica e tyre varen nga këta faktorë:

Lartësia e diellit mbi horizont, zgjatja e ditës, sasia dhe forma e reve dhe tejdukshmëria e atmosferës.

Temperatura e ajrit

Temperatura mesatare vjetore e ajrit luhetet nga 15.2°C deri në 14.8°C. Kjo afërsi temperaturash është prezente për çdo muaj të vitit. Temperaturat më të larta u takojnë muajve Korrik dhe Gusht, ku arrin vlerën 23.9°C.

temperaturat më të ulëta vrojtohen gjatë muajit Janar, në të cilin temperatura mesatare është 7.3°C. Temperatura mesatare e muajit Janar është 7°C dhe për muajin Korrik e Gusht është 24°C, ndërkohë që temperatura mesatare vjetore është rreth 15°C.

Vlerat e maksimumeve të temperaturave të larta lëviz në kufijtë 40- 42°C, dhe vlera e minimumeve të temperaturave të ulëta lëviz deri në -4°C, por më



The bottom of the page features a handwritten signature in blue ink. Below the signature are two official stamps. The first is a circular stamp from the Roskovec Municipality, and the second is a rectangular stamp from the Roskovec District Office, both in blue ink.

të përsëritshmet dhe që përbëjnë një veçori të saj janë vlerat e temperaturës minimale deri në - 20 - 50.

Temperaturat negative janë karakteristike për muajt e dimrit, por ato mund të vërehen dhe në muajt e mvjeshtës (Nëntor) dhe të pranverës (Mars).

Lagështira relative mesatare e ajrit në %.

Fieri dhe zona përreth tij karakterizohet nga një lagështirë relativisht e lartë, me vlerë të mesatares vjetore 70%. Vlera më e ulët vrojtohet në Korrik 61% dhe atë më të lartë në Dhjetor me 76%.

Reshjet atmosferike

Një element tjetër mjaft i rëndësishëm për të karakterizuar klimën e një vendi, janë rreshjet atmosferike.

Edhe sipas reshjeve, kjo zonë paraqitet mjaft homogjene.

Reshjet mesatare vjetore luhaten nga 1219.2 mm deri në 1045.8 mm.

Sasia më e madhe e tyre, rreth 65% , bie gjatë gjysmës së ftohtë të vitit.

Muaji më i lagët është muaji Nëntor, gjatë të cilit në bie 165 mm. Muaji më i thatë është muaji Korrik, në të cilin bien 39 mm.

Madje vlera të përafërta vërehen edhe në maksimumet 24 orëshe të reshjeve, të cilat janë një tregues që ndryshon shumë në hapësirë. Konkretisht, sasia maksimale e reshjeve të rëna gjatë 24 orëve është 149.6 mm.

Era

Në zonën tonë mbizotërojnë erërat lindore dhe juglindore. Një erë tjetër karakteristike është dhe murlani, që sa vjen e dobësohet drejt pjesës qendrore të ultësirës, ku bën pjesë dhe rajoni ynë, e cila sjell shpesh pasoja negative. Në rajon ndihen mirë dhe erërat e nxehta e të thata, që kanë rastisje jo të vogël.

Vlera mesatare e orëve me diell në këtë zonë lëkundet në kufijtë 2600-2700 orë, ndërkohë që numri i ditëve me diell lëviz në diapazonin 330 ditë.

Ngjarjet e pazakonta klimatike

Ndër dukuritë e pazakonta klimatike bëjnë pjesë edhe ato që lidhen me regjimin e reshjeve.

Zona jonë si pjesë e një rajoni siç është Shqipëria, me klimë tipike mesdhetare, karakterizohet nga një regjim i çrregullt i reshjeve nga



pikëpamja e shpërndarjes vjetore. Kjo shpërndarje karakterizohet nga një maksimum në muajt e dimrit (30-40% e reshjeve vjetore) dhe një minimum në muajt e verës (10%).

Çrregullsia e reshjeve vihet re edhe në shpërndarjen e tyre gjeografike.

Kështu, në shkallë lokale herë pas here ndodhin me ngjarje jo të zakonta si reshjet intensive brenda 24 orëve të shoqëruara në disa raste me përmbytje apo mungesa e theksuar e reshjeve që sjell thatësira të zgjatura.

Rajoni i studiuar karakterizohet nga një sasi jo e vogël reshjesh, rreth 1100-1300mm në vit.

Shpërndarja e rreshjeve, mesatarisht është si vijon:

në dimër rreth 420mm, në pranverë rreth 340mm, në verë rreth 150mm dhe në vjeshtë rreth 360mm shi.

Ndertimi dhe kushtet gjeologo – inxhinerike te zones

Nga ana gjeologjike dhe gjeomorfologjike zona e Fushes së Roskovecit ku shtrihen edhe objektet e këtij projekti, përfaqeson ultesirën e luginës së Semanit që përshkon strukturën Sinklinale të Roskovecit, strukturën Antiklinare të Zharrezes dhe Sinklinarin e Patosit.

Keto struktura me shtrirje të përgjithshme kryesisht VP – JL (Veri Perëndim – Jug Lindje) ndërtohen nga formacionet Neologjike të përfaqësuara nga argjilore, alevrolite, ranore e konglomerate dhe përbejnë vargun kodrinor që rrethon masivin në anën jugore të tij si dhe përbejnë fundamentin e depozitimeve kuaternare të cilat mbushin gjithë ultesirën e luginës së lumit Seman.

Përgjithësisht zona në fjalë përbën ultesirën e luginës së lumit Seman të përfaqësuar nga depozitimet kuaternare që ndërtojnë gjithë pjesën fushore të saj.

Keto depozitime përfaqësohen kryesisht nga depozitimet aluviale të lumit të Semanit të përbera nga dhëra suargjilore të lehta dhe surana të pluhuruara me ngjyrë gri si dhe nga rana e zhavore të cilat ndeshen në zonën e shtratit të lumit dhe pranë tij si dhe në perrenjtë e tjera të zones.



Ne ndonje rast takohen edhe depozitime me origjine kenetore me permbajtje te paket torfike te cilat ndeshen ne zonat e meandrimave te vjetra te lumit kryesisht ne pjesen V-P te Rockovecit (ish keneta e Roskovecit) si dhe ne afersi te zones naftemabjtese te Marinzes etj.

Veç depozitimeve te larte permendura, ne rreze te vargut kodrinor kemi te bejme me depozitimet deluviale te perfaqesuara nga dherat suargjilore ngjyre kafe te hapur me pak fraksione çakellore.

Trashesia e pergjitheshme e depozitimeve kuaternare ne kete zone eshte mbi 10 m ndersa ne afersi te kodrave arrin 2-3m.

Pergjithesisht rrjeti i kanaleve kullues duke filluar qe nga kolektori kryesor Roskovec- Hoxhar e me tej karakterizohet teresishte i ndertuar mbi depozitimet aluviale te lumit Seman te perbere nga dhera suargjilore te lehta te pluhuruara ngjyre gri-ne kafe te hapur ne gjendje pak deri mesatarisht te ngjeshura ku ne disa zona ku kolektori i afrohet shtratit te lumit Seman vihen re edhe ndershtresa apo linza rane te imet.

Edhe ne zonen pertej perroit te Zharrzes, kemi te bejme me depozitime deluviale- aluviale te perfaqesuara po nga dhera suargjilore te lehta te cilat gradualisht kalojne ne suargjile te lehta pluhurore me ngjyr gri- ne kafe te hapur.

Jane kryer disa studime te mirefilta gjeologo-inxhinierike ne kete zone ,perfshi edhe studime gjeologo-inxhinierike te kryera gjate hartimit te projekteve origjinale në vitet 1958-1960 , te cilat jane bazuar ne shume cpime gjeologjike te realizuara me ane te sondave te zhytura ne thellesi deri ne disa dhjetra ml.



Referuar ketyre studimeve gjeologo-inxhinierike (shih referencat), nga autori i studimit jane marre ne konsiderate dhe jane perpunuar te dhenat e nevojshme per shtresat e ndryshme gjeologjike te strukturese se tokes dhe pozicionet e vendosjes se tyre.

Mbi bazen e ketyre perpunimeve dhe te treguesve te tjere fiziko-mekanike te ketyre strukturave , jane percaktuar edhe parametrat e nevojshem inxhinierik per vleresimin e strukturese se dherave dhe propabilitetit te tyre per tu deformuar e shkare ne dem te mbrojtjes se mjedisit.



Prerje gjeologjike ne aksin e Kolektorit

Në menyre te veçante mbi keto studime jane vleresuar :

- *qendrueshmeria e skarpatave dhe percaktimi i kendit te pjerresise se realizimit te ketyre skarpatave,*
- *vleresimi dhe testimi i treguesive fiziko-mekanike te ketyre formacioneve per percaktimin e ngarkesave te mundeshme dhe aftesive mbajtese , ne ndertimin apo rikonstruksionin e mjaftve veprave te artit ne keto kanale .*
- *vleresimi dhe testimi i treguesive fiziko-mekanike per percaktimin e shpejtesive te lejuara te mundeshme ne dimensionimin hidraulik te rrjetit te kanaleve kullues e ujites*
- Ne fotot bashkengjitur (Shih) jane pasqyruar nje prerje gjeologo - litologjike e strukturave te tokes e realizuar me me cpime gjeologjike ne afersi te KRH (Kolektorit Roskovec Hoxhar)
Si dhe nje test laboratorik per percaktimin e disa prej treguesve fiziko-mekanike te perberjes se formacioneve tokesore
- Sipas ketij studime jepen keta tregues te perfaert per granulometrine e formacioneve dhe te perberjes fiziko-mekanike te ketyre shtresave



Perberja granulometrike :

- Fraksioni argjilor 35-38 %
- Fraksioni pluhuror 35-53%
- Fraksioni ranor > 6-28 %

Treguesit Fiziko-mekanik :

-pesha specifike... 2,65-2,74
g/cm³

-pesha volumore ...1.8-1.9 g/cm³

- pesha skeletit ...1.39-1.43
g/cm³

-Lageshtia natyrale 29-39%

-poroziteti ... 0,91- 1,0

-kendi ferkimit brendshem..13-
17°

-Kohezioni 0,3 kg/cm²

- σ (ngarkesa e lejuar ne shtypje)
...1,2 - 1,5 kg/cm²


Nga vrojtimi fizik i seksioneve te rrjetit te kanaleve qe pershkojne fushen , veçanerisht

ne rrjetin e kanaleve kullues vihet re lehtesisht se ata nuk ruajne konfiguracionin e rregullt te seksionit terthor te tyre per shkak te perpunimit e deformimit te skarpateve, apo te mbushjeve me dhe ,ose me mbeturina te ndryshme dhe ne menyre te veçante me bimesi te dendur, gje qe e bene te veshtire funksionimin normal te tyre.

Ne tabane te disa kanaleve kullues disa here takohen edhe aluvionet e formacioneve rrenjesore te perbera nga **argjila dhe ranore alevrolitike.**

Project : Canal Treating Facility For Albania
Site :
Borehole : BH- 1
Depth : 2.5-3.0m

SAMPLE : 1



Unconfined Compression Test Machine
Mod. T 0179

DATE : November, 2004

Spring No	Max Reading	Spring Factor	Comp Stress kN/m ²
2	4.569	23	105



Ne te njejtat formacione gjeologo – inxhinierike jane ndertuar e do te rindertohen stacionet e pompimit si dhe rrjeti i kanaleve kullues e ujites . Ku pothuajse ne tere shtrirjen e tyre , ata mbështeten mbi formacionet baze, kryesisht te ndertuar , nga formacione me dhera deluviale te perbera nga suargjila te lehta ngjyre kafe te hapur te pluhuruara dhe mesatarisht te ngjeshura.

Shpesh në tabanet e ketyre kanaleve disa here takohen edhe aluvione te formacioneve rrenjesore te perbera nga argjila dhe ranore alevrolitike.

Nga pikpamia tektonike zona ne studim ben pjese ne Zonen e Ultesires Adriatike.

Bazuar ne rikonjicionin gjeologjik te kryer ne vend nga autoret e studimit si dhe informacionin e mare nga studime te here pashereshme qe jane bere edhe per objekte te tjera, te ngjashme ne kete zone, mund te thuhet se formacionet gjeologjike qe takojme ne kete zone perfaqesohen nga formacionet bazike të ultesiren e lugines se Semanit qe pershkon gjithë strukturen Sinklinale te Roskovecit, strukturen Antiklinare te Zharrezes dhe Sinklinarin e Patosit, te ndertuara nga formacionet Neologjike e te perfaqesuara nga argjilore, alevrolite, e rralle ranore e konglomerat

Sizmiciteti

Zona jone e studimit, bazuar ne hartën e Rajonizimit Sizmik te Republikës Shqiperise, karakterizohet nga lekundje sizmike prej 8 balesh.

Harta e Rajonizimit Sizmik te Republikës Shqiperise.

III. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Objekti “ Për rritjen e sigurisë së digës dhe përmirësimin e ujitjes me rezervuarin e Kurjanit” BASHKIA ROSKOVEC” ndahet ne disa nenobjekte si me poshte:

Stacioni i Pompimit, në Matkë

Projekti ka parashikuar punime per ndertimin e godines se stacionit,



te vaskes se thithjes dhe te furnizimit me energji elektrike te ketij stacioni.

Po ashtu eshte parashikuar kompletimi i ketij stacioni me pajisjet e nevojshme ku perfshihe dy + tre elektropompa se bashku me transformatorin dhe panelet e komandimit.

Janë parashikuar dy linja tubacioni i dergimit per kete stacion Pompimi
- Linja e pare me gjatesi rreth 130 m, me diameter Fi 609/7mm, do te furnizojë kanalën ujtes VMK-1, ose kanalin I dges se majte te rezervuarit te Kurjanit.

, Në këtë rast kjo dege do te ujjti kryesisht , tokat e fshatrave Strum e Velmish.

- Linja e dyte e tubacionit te dergimit , me gjatesi rreth 330 m do të përcjellë ujin nga Stacioni I pompimit te Matkes deri ne dalje (nje prevalence prej rreth 32 m). Dhe qe aty , nepermjet nje kanali ujtes me kuote te kerkuar (Shih profilin gjatesor) , i cili është parashikuar të vishet me betoon M 200 perforcuar me nje zgare hekuri Fi6-8 mm, e vendosur në forme kuadratike 20x20 cm do te përcjelle ujin per në rezervuarin e Kurjanit , duke plotësuar në këtë menyre deficitet qe krijohen në mbushjen me uje nga baseni shimblethes i këtij rezervuari.

IV.- TE DHENA PER MJEDISIN EGZISTUES

Problemet kryesore mjedisore, qe potencialisht mund te lindin gjate se funksionimit te tij do te jene :

1.- Prodhimi i pluhurave

Gjate punes per ndertimin e ketij objekti krijohen pluhura te ndryshem, por sasia e tyre nuk eshte e përditëshme dh jo në nivele te larta. Do të kete disa grmime për kanalet e linjat e tubacioneve por shumica e dherave do te sistemohet ne bankina ose për mbulimin e tubacioneve.

- Në këtë rast transporti I dherave është ne volume relativisht te vogela.



- 2.- Krijimi i zhurmave

Si rezultat i perdorimit te paisjeve te sherbimeve, do krijohen disa zhurma te ndryshme.

3.- Krijimi i mbeturinave nga sherbimet

Gjate proceseve te ndryshme te sherbimeve krijohen mbeturina te karaktereve te ndryshme.

V.- NDIKIMI I MUNDEHEM NE MJEDIS DHE MASAT E PROPOZUARA PER PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E TYRE

Duke patur parasysh shtrirjen jo në përmasa të mëdha të territorit ku do të kryhen punimet dhe gjëndjen aktuale, mendohet se kompensimet dhe ndikimet e tjera pozitive, si punësimet, disa përmirësime në infrastructure marrin një rëndësi të veçantë për komunitetin e rajonit.

- Këto ndikime nxisin edhe komunitetin për mbështetjen e investimeve.

Avantazhet dhe dobësitë e mundeshme në infrastrukturës aktuale të mjedisit të rajonit

AVANTAZHET	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • <input type="checkbox"/> Vendndodhja - Vendndodhja pjesërisht në dhe pranë një Liqeni (rezervuari) - Ka potencial për zgjerimin e aktiviteteve e të shlodhjes; • <input type="checkbox"/> Administrimi i tokës dhe planifikimi i shfrytëzimit të saj; - Kapaciteti rregullator, relativisht i fortë i rajonit në lidhje me mbrojtjen e hapësirave të gjelbërta; • <input type="checkbox"/> Pronësia dhe regjistrimi i tokës 	<ul style="list-style-type: none"> • <input type="checkbox"/> Administrimi dhe planifikimi i shfrytëzimit të tokës : - Shtrirja jo gjithënjë e planifikuar urbane; - Në aktivitetet ndërtimore nuk merren në konsideratë zonat e rreziqeve gjeologjike, tektonike e sismike; - Humbja e tokave bujqësore, për shkak të aktiviteteve ndërtimore të pakontrolluara - Kapaciteti planifikues dhe zhvillues i rajonit i pamjaftueshëm;

<ul style="list-style-type: none"> - Konflikte të zgjidhura lidhur me të drejtat e pronësisë - Përqindja e lartë e pronës private, si bazë për motivim dhe zhvillim; - Prezençë e tokave publike - Prezençë objekteve publike 	<ul style="list-style-type: none"> - Aktivitete pjesërisht të pa organizuara ndërtimore, si pasojë e zhvillimeve spontan ; - Instrumenta të dobët për planifikimin dhe zbatimin e planeve; - Siperfaqet relativisht të pamjaftueshme për zhvillimin e industrive të teknologjive të avancuara; - Pronësia private si pengesë për administrimin e mirë të tokës
---	--

Avantazhet dhe dobësitë e mundshme në lidhje me infrastrukturën teknike bashkiake

AVANTAZHET	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi me ujë per permiresimin e ujitjes : - Aktivitete të realizuar në shtrirjen e sistemit të ujitjes furnizimit me ujë - Personel i kualifikuar relativisht mire. <ul style="list-style-type: none"> - Prezenca e rrjedhes me te sigurt e lumit te Semanit - Kapacitetet kërkimore në fushën e hidrogeologjisë; • Sistemimi i ujërave të zeza: - Njohuri teknike në trajtimin e ujërave të zeza; - Kapaciteti 	<ul style="list-style-type: none"> • Furnizimi me ujë: - Burime të pa mjaftueshme sipërfaqësore dhe nëntokësore ujore; - Furnizim i pamjaftueshëm me ujë, gjatë periudhave të thatësisë, me pasoja negative për biznesin, bujqësinë, turizmin dhe jetën private; - Humbje të pakontrolluara të ujit për vaditje, për shkak të nderhyrjeve në sistemin e kanaleve dhe ndërhyrjeve të paligjshme - Administrimi jo efektiv i ujërave; • Sistemi i ujërave të zeza:

<p>kërkimor në fushën e trajtimit të ujërave të zeza.</p> <p>• Administrimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri në trajtimin e mbetjeve urbane; - Kapaciteti kërkimor në fushën e trajtimit; <p>• Furnizimi me energji elektrike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konceptimi i furnizimit me energji elektrike bazohet në vlerësimin e kërkesave të së ardhmes; - Agjensitë financuese respektojnë këtë koncept dhe nxisin zbatimin e tij; - Rinovimi i rrjetit energjistik e sistemi i furnizimit sipas standarteve Europiane; 	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e një trajtimi të mirë kontrolluar te ujërave të zeza, me pasojë derdhja e ujërave të ndotur në kanalet kullues. <p>• Administrimi dhe trajtimi i mbeturinave të ngurta;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mostrajtimi dhe ndarja ekologjik i mbetjeve; <p>• Furnizimi me energji elektrike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Paqëndrueshmëri në furnizim me energji elektrike
--	--

<p>• Telekomunikacioni</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezenca e shërbimeve të telefonisë së 	<ul style="list-style-type: none"> - Rrjete të vjetër dhe administrim jo efektiv sistemit të
--	---



<p>lëvizshme dhe fikse me kompani private;</p>	<p>furnizimit me energji;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çmime të papërshtatshme për energjinë; - Nuk ka tradita në përdorim të energjisë diellore - Nuk ka tradita në përdorim të energjisë së erërave - Nuk ka tradita në përdorim të energjisë ujore <p>• Telekomunikacioni</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbulimi i pa mjaftueshëm i fshatrave; - Nuk ka sisteme të mjaftueshëm të parandalimit të zjarreve;
--	---

Avantazhet dhe dobësitë e mundshme në lidhje me kushtet natyrore dhe mjedisin në zonë.

AVANTAZHET	DOBËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • <input type="checkbox"/> Plani kombëtar i Veprimit për Mjedisin; • <input type="checkbox"/> Disponueshmëria e burimeve ujore (rezervuarëve); • <input type="checkbox"/> Tokat pjellore; • <input type="checkbox"/> Kushte të favorshme klimatike; • <input type="checkbox"/> Pejsazh interesant; • <input type="checkbox"/> Cilësia e ajrit shumë e mirë; • <input type="checkbox"/> Zbatim të Projekteve kombëtare për rehabilitimin e veprave kulturore; • <input type="checkbox"/> Zbatim të Projektit të kombëtare për 	<ul style="list-style-type: none"> • <input type="checkbox"/> Ndërtimet e paligjshme; • <input type="checkbox"/> Prezence i ndotjes së ujit, për shkak të mos trajtimit të ujërave të zeza; • <input type="checkbox"/> Ndotja, për shkak të mos trajtimit të mbeturinave urbane; • <input type="checkbox"/> Teknologjitë dhe fabrikat e ndryshme janë kërcënuese për mjedisin; • <input type="checkbox"/> Konflikti midis shkarkimit të hapur të ujërave të zeza dhe sistemit të kullimit; • <input type="checkbox"/> Zonat lumore që nuk

kalimin e pyjeve ne pyje komunal; Shkalla e lartë e erozionit në kodrat me pjerësi, për shkak të degradimit të pyjeve.	merren gjithnje në konsideratë gjatë zhvillimit të aktiviteteve; • <input type="checkbox"/> Mbeturinat e ngurta mund të shkarkohen në vende të hapura dhe të shpërndara; • <input type="checkbox"/> Plani Kombëtar i veprimit për Mjedisin nuk zbatohet;
---	--

Komponentët më të ndjeshëm ndaj ndotjeve

Ndotja e ajrit

Pluhurat që dalin nga proceset e ndërtimit, si dhe shkarkimi i gazrave të makinave janë burimet e mundëshme të ndotjes së ajrit, të cilat mund të rrisin përqëndrimin e materialeve të imta në të.

Pjesa më e madhe e pajisjeve do të operojë në një ambient të hapur, me një dispersion të madh, për shkak të rrymave dhe erërave. Ndikimi në ndotjen e ajrit, qe rendom mund të konsiderohet i lartë.

Standartet për kontrollin e cilësisë së ajrit dhe shkarkimeve të ndotëse në mjedis

Ndotësi	Autoriteti	Vlerat mesatare të elementeve ndotës					
		SO ₂	NO _x	Vjetore	24h MAX	Ditore	Orare
BANKA BOTËROE	0.10	0.5 (jashtë)	1.0 (brënda)	0.05 ppm	-	0.05	-
SHBA	0.02ppmwacç 0,03ppmwbcç	0.1ppmwacç 0.14 wbcç 0.5ppm wacç	-	0.05 ppm	-	-	-
WHO	-	90µg/m ³	-	-	-	-	190



Raporti për vlerësimin dhe ndikimin në mjedis (V.N.M.)

							320 µg/m ³
EU		80 µg/m ³					

Ndotja e ajrit nga grimcat e ngurta

Rrugët ndihmëse të furnizimit me lëndë do të trajtohen vazhdimisht me ujë përpara se

të kalojnë automjetet, duke evituar kështu gjenerimin e pluhurave.

Efektet e dëmshme të ajrit të ndotur

Elementet që gjenden në ajër ushtrojnë efekte negative në shëndetin e njeriut.

Këto efekte manifestohen në forma të ndryshme, që fillojnë me shqetësime në frymëmarrje, vazhdojnë me sëmundje kronike profesionale dhe arrijnë deri në intoksikacione të rënda, madje deri në vdekje.

Aktualisht, studiuesit ndjekin pikërisht këto efekte, që vijnë

si pasojë e ekspozimit për një kohë të gjatë me substanca ndotëse të veçanta ose të përziera.

Organet e para që preken nga këto ndikime janë organet e frymëmarrjes.

Ajri që thithet nga njeriu hyn në kontakt me gjakun dhe përhapet në gjithë trupin.

Efektet e dëmshme të gazeve

Veprimi i dëmshëm i gazeve ushtrohet kryesisht në rrugët e frymëmarrjes.

Shpesh, ai vepron në kombinim me grimcat e ngurta. Gazet, në pjesën më të madhe të rasteve kanë veçoritë e tyre karakteristike, në mekanizmin e veprimit në organizëm.

Ndërmjet gazeve, që ndotin atmosferën mund të përmendim CO₂, CO, SO₂, SO₃, H₂S etj.

Këto japin efekte të dëmshme në rrugët e sipërme të frymëmarrjes, për shkak të tretshmërisë së tyre.

Gazet, që kanë në përbërje azotin ushtrojnë veprim toksik në rrugët e thella të frymëmarrjes.

The bottom of the page features several official stamps and handwritten signatures. On the left, there is a circular stamp with the text 'KOMUNA ROSKOVEC' and a signature. In the center and right, there are larger circular stamps. One is from the 'REPUBLIKA E SHQIPËRISE' (Republic of Albania) and another is from the 'BASHKIA ROSKOVEC' (Roskovec Municipality). There are also several overlapping handwritten signatures in blue ink.

Efektet pathologjike të gazeve shfaqen në këto sëmundje:

- □ bronkiti kronik;
- □ asma bronkiale;
- □ sëmundje të aparatit të frymëmerrjes, etj.

Nga studimet e kryera mbi popullsinë e zonave të ndotura është vënë re rritje e sëmundshmërisë me kalimin e kohës. Këtu mund të përmendim pneumoninë, bronkitin, tuberkulozin dhe sidomos, ato të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes, siç janë rihinite, faringite, otite etj.

Duke patur parasysh që ndotja e ajrit është prezente duhet të ndërmeren masa të ndryshme praktike për të ulur ndikimin negativ, që ato kanë në rrugët e frymëmarrjes.

Zhurmat dhe dridhjet

Zhurma nga aktivitetet e ndërtimit mund të jetë e rëndësishme për një periudhë të kufizuar kohe.

Nivelet e zhurmës të shkaktuara nga aktivitetet e ndërtimit mund të ndryshojnë shumë, në varësi të fazës së ndërtimit dhe detyrës specifike, që po kryhet.

Të gjitha pajisjet që lëshojnë zhurmë do të mirëmbahen ashtu siç duhet për të minimizuar ndikimin e zhurmës në rajon.

Pajisjet që lëshojnë zhurmë do të jenë sipas standarteve të BE rreth zhurmës së shkaktuar në mjedis.

Gjatë periudhës së ndërtimit, zhurma që do të gjenerohet do të jetë e neglizhueshme. Burimet e vetme të mundshme do të jenë motorët e pompave, por ata do të vendosen në vendet të mbyllura dhe të izoluara. Në vijim paraqiten nivelet maksimale të zhurmës, që pranohet.

- □ E vazhdueshme 1.000 m nga kompleksi 45 dBA;
